

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap.-Kž. nr. 409/2008**  
**12 mars 2009**  
**Prishtinë**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e formuar në pajtim me nenin 26, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), dhe në pajtim me nenin 15.4 të Ligjit mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e rasteve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë ("Ligji mbi juridiksionin), të përbërë nga:

- gjyqtari i EULEX-it Guy Van Craen në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues dhe të gjyqtarit raportues,
- gjyqtarja e EULEX-it Maria Giuliana Civinini,
- gjyqtari i EULEX-it Emilio Gatti
- gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës Avdi Dinaj dhe
- gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës Fejzullah Hasani, si anëtarë të kolegjit,

të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Judit Eva Tatrai si procesmbajtëse, Valentina Gashi dhe Robert Abercrombie si daktilografë gjyqësorë të EULEX-it dhe Arlinda Gjebrea, Anila Shehu, Mentor Abdullahu dhe Naser Sylja si përkthyes të EULEX-it, në praninë e prokurorëve publikë Anette Milk nga EULEX-i dhe Ismet Kabashi prokuror publik vendor, avokatit mbrojtës Mahmut Halimi dhe të pandehurit Florim Ejupi, në seancën e mbajtur më 10 mars 2009, pas shqyrtimit të kolegjit të përmbyllur më 12 mars 2009;

Në lidhje me rastin penal kundër:

**Florim EJUPIT**, me pseudonimin Luli, i biri i Mursel Ejupit and Fatime Berishës, i lindur më 15 qershor 1978, në Gllamnik, komuna e Podujevës, shqiptar kosovar, me adresë të përhershme banimi të fundit në fshatin Sekiraçë, komuna Podujevë, Kosovë, i martuar, baba i dy fëmijëve, me tetë klasë të kryera të shkollës fillore, me profesion bujk, me një gjendje të mesme ekonomike, i padënuar më herët, i mbajtur në paraburgim në mes të datës 19 mars dhe 14 maj 2001, dhe në burgim të pandërprerë që nga data 8 qershor 2004;

Të shpallur fajtor me vendimin P. Nr. 202/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 6 qershor 2008, për këto vepra penale:

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.- Kž. nr. 409/2008  
Florim Ejupi

**Vrasje**, në kundërshtim me nenin 30, paragrafët (1), (2), pikat 1, 2 dhe paragrafin (3) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), ligje këto të zbatueshme me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24; **Vrasje në tentativë**, në kundërshtim me nenin 30, paragrafët (1), (2) pikat 1, 2 dhe paragrafin (3) të LPK-së, në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KP-së së RSFJ-së; **Terrorizëm**, në kundërshtim me nenet 22 dhe 125 të KP së RSFJ-së; **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm**, në kundërshtim me nenin 157, paragrafët (1), (3) të LPK-së, në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së; **Diskriminim racor dhe tjetër**, në kundërshtim me nenin 22 dhe 154 të KP të RSFJ-së; dhe **Mbajtje e paligjshme e substancave shpërthyes**, në kundërshtim me nenin 199, paragrafët (1), (3) LPK-së;

Të dënuar me dënim të integruar prej dyzet (40) vjet burgim, duke llogaritur në të kohën e kaluar në paraburgim prej datës 19 mars deri më 14 maj 2001, dhe në vuajtje të pandërprerë të burgimit prej datës 8 qershor 2004, duke pritur datën kur aktgjykimi të merr formën e prerë;

Duke vendosur përkitazi me ankesën e avokatit mbrojtës Mahmut Halimi, të parashtruar në dobi të të pandehurit Florim Ejupi më datën 4 shtator 2008, të plotësuar më 10 tetor 2008, kundër aktgjykimit P. nr. 202/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 6 qershor 2008;

Pas rishikimit të procesverbaleve gjyqësore, pas dëgjimit të provave të avokatit mbrojtës dhe të atyre të prokurorit publik dhe pas analizës së ligjeve përkatëse, Gjykata Supreme e Kosovës sjell këtë

## AKTGJYKIM

Mbi **PRANIMIN** e ankesës së avokatit mbrojtës Mahmut Halimi të paraqitur në favor të të pandehurit Florim Ejupi më 4 shtator 2008, të plotësuar më 10 tetor 2008, dhe mbi **NDRYSHIMIN** e aktgjykimit P. Nr. 202/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 6 qershor 2008;

Florim Ejupi shpallet i **PAFAJSHËM** dhe **LIROHET** nga të gjitha akuzat.

## Arsyetim

### 1. Lidhur me procedurën:

1.1 Ankesa e të pandehurit Florim Ejupi është e pranueshme, e paraqitur në mënyrë të rregullt dhe në kohë të duhur.

1.2 Gjykata Supreme është kompetente për të vendosur përkitazi me ankesën e pranuar nga i pandehuri Florim Ejupi, në kolegjin prej pesë gjyqtarësh të Gjykatës Supreme. Përbërja me ligj e kolegjit prej tre gjyqtarësh të EULEX-it nga Gjykata Supreme dhe dy gjyqtarë kosovarë të Gjykatës Supreme, e përcaktuar nga Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it dhe e konfirmuar *limine litis*, me vendimin e Kryetares së Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, të datës 10 mars 2009, në përputhje me Ligjin mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e rasteve, ka dëgjuar palët e pranishme në seancën e Gjykatës Supreme, të mbajtur më 10 mars 2009.

1.3 Edhe pse e ftuar me kohë, pala e dëmtuar nuk është paraqitur gjatë seancës.

1.4. Procedura ankimore dhe seanca e Gjykatës Supreme janë mbajtur në përputhje me Kodin e procedurës penale të Kosovës, në veçanti me kapitullin XXXVI, 4 / në mes tjerash me nenet 409, 410 (1, 2, 3, 4), 411, 412.

1.5 Vendimi (shih dispozitivin) është marrë në pajtim me nenin 426 (1) të KPPK-së.

### 2. Lidhur me arsyet e ankesës:

2.1 Në thelb, mbrojtja nuk kundërshton faktet materiale ashtu si janë vendosur nga aktgjykimi i shkallës së parë, POR kundërshton arsyetimin e mbështetur në këto fakte materiale dhe në pasojat e lidhura për këto fakte të vendosura që ka rezultuar me shpalljen fajtor të të akuzuarit. Mbrojtja ka theksuar në ankesën e tij se dy dëshmitë më të rëndësishme (rezultatet e ADN-së në lidhje me bishtin e cigares dhe deklarata(t) e dëshmitarit Alfa) jo vetëm që janë të kontestueshme por gjithashtu edhe me defekte, prandaj gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të mbështetet në të tilla "dëshmi" për të ardhur gjer te konstatimi i fajësisë së të akuzuarit. Mbrojtja thekson *adagium "in dubio pre reo"* që domethënë se elementet e dyshimit duhet të shkojnë në favor të të akuzuarit dhe/ose të interpretohen në favor të tij.

2.2 Në thelb, Prokurori ka nënvizuar vendosjen e fakteve materiale dhe pranueshmërinë e dëshmimeve mbi të cilat mbështetet aktgjykimi i ankimuar, në veçanti besueshmëria e dëshmitarit Alfa dhe rregullsitë e ekzaminimit të përpiktë shkencor të bishtit të freskët të cigares të gjetur në vendin e krimit. Prokurori theksoi se gjithashtu

janë gjetur edhe dëshmi të tjera në vendin e krimit, të cilat paraqesin fakte materiale vërtet të pakundërshtueshme – të përshkruara nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Prokurori konstatoi se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet që të konfirmohet nga Gjykata Supreme ndërsa ankesa duhet të hedhet poshtë si e pabazë.

### 3. Lidhur me dëshmitë:

3.1. Gjatë ekzaminimit të dëshmimeve të paraqitura gjatë procedurës penale gjer më tani, duke marrë parasysh se aktgjykimi mund të mbështetet vetëm në ato dëshmi që paraqiten në shqyrtimin kryesor (neni 387.1 i KPPK-së), kolegji vëren se NUK KA dëshmi të drejtpërdrejta mbi praninë e të akuzuarit në vendin e krimit duke i përgatitur apo duke i kryer krimet për të cilat është shpallur fajtor. Dëshmitë (e kontestueshme), të cilat lidhin të akuzuarin me krimin dhe me ditën janë rezultatet e përmendura të ADN-së të gjetura në bishtin e cigares si dhe deklaratat e dëshmitarit Alfa.

3.2. Përkitazi me ekzaminimin e dëshmimeve të ADN-së, kolegji konstaton se këto dëshmi janë me defekte për shkaqe të ndryshme. Kolegji ka konstatuar se nuk ekziston ekspertizë përfundimtare objektive dhe shkencore e cila do të dëshmonte me një siguri të arsyeshme nëse cigarja është tymosur para apo pas shpërthimit. Vetë deklarata, qoftë lidhur me kushtet atmosferike atë ditë dhe një ditë më herët apo qoftë lidhur me vendin relativ të mbyllur të krimit, e dhënë nga zyrtari/zyrtarët hetues, nuk është e mjaftueshme për të konstatuar se ajo cigare është tymosur (pirë) gjatë përgatitjes apo gjatë ekzekutimit të sulmit me bombë ndaj autobusit. Të qenit “i freskët” nuk na mundëson të kuptojmë një kohë të saktë; më së shumti që mund të kuptojmë me këtë rast është indikacioni se bishti i cigares nuk ka qenë aty një ditë më herët. Përveç përfundimit të kontestueshëm se telat elektrike të zhveshur provojnë vendndodhjen e pikës komanduese, pranë vendit ku është gjetur bishti i cigares, nuk ka dëshmi të tjera apo indikacione të pajtueshme, të cilat provojnë vendndodhjen e saktë të pikës komanduese, të vendit të vëzhgimit dhe të llojit të pajisjes elektrike që ka shkaktuar shpërthimin.

Për më tepër, nuk ka prova të mjaftueshme që vërtet bishti i cigares i gjetur në vendin e krimit është e njëjta cigare (nuk ka raport hetimor lidhur me gjetjen, mbylljen dhe shënimin e dëshmisë), e cila i është nënshtruar testit krahasues me mostrën e ADN-së që është mbajtur në Gjermani (mostra e mëhershme e ADN-së e marrë për një vepër tjetër penale të kryer nga i akuzuari). Në fund, duhet të përmendet fakti se raporti i plotë i mëhershëm në lidhje me veprat penale në Gjermani, analizat e ADN-së (marrja e mostrës, ekspertiza shkencore, paraqitja e ADN-së) as nuk është kërkuar as nuk i është bashkëngjitur lëndës. Kolegji nuk ka qasje në raportin e plotë përkitazi me analizën e ADN-së në Gjermani, prandaj për këtë arsye nuk është në gjendje ta bëjë vlerësimin e kësaj analize as në aspektin material as në atë ligjor.

Për këtë arsye, duke i marrë në konsideratë arsyet e përmendura më lart, Kolegji nuk pranon testin krahasues i cili ka konstatuar që ADN-ja në bishtin e cigares përputhet me

ADN-në e të pandehurit, si një dëshmi bindëse që provon praninë e të pandehurit në vendin e krimit duke përgatitur apo duke ekzekutuar veprën penale për të cilën është akuzuar.

3.3. Gjatë ekzaminimit të dëshmive të mbledhura nga deklaratat e dëshmitarit Alfa, kolegji konstaton se këto dëshmi janë me defekt për arsye të ndryshme dhe nuk mund të shërbejnë si provë e pjesëmarrjes së të akuzuarit në shpërthimin me bombë të autobusit. Sidoqoftë, një aktgjykim i tillë nuk mund të mbështetet vetëm në deklaratat e një dëshmitari anonim (neni 157 i KPPK-së).

Kolegji vëren se dëshmitari Alfa ka qenë i përgatitur dhe i udhëzuar nga policët hetues që të infiltrohet në grupin e të akuzuarve në Burgun e Dubravës, me qëllim të mbledhjes së informatave rreth pjesëmarrjes së të pandehurit (dhe eventualisht të personave të tjerë) në shpërthimin e autobusit. Duhet të ceket se ky lloj i “teknikës së infiltrimit” nuk është urdhëruar apo kontrolluar nga gjyqtari i procedurës paraprake. Për më tepër, nuk ka asnjë dyshim se dëshmitarit në fjalë i janë bërë premtime dhe favore të ndryshme si shpërblim për bashkëpunimin e tij të rrezikshëm në këtë rast. Këto premtime dhe favore jo vetëm që janë hequr nga deklaratat e vetë dëshmitarit por edhe nga ato të hetuesve dhe këtë më së miri e ilustron përpjekja e tij e suksesshme për ta fituar statusin e “dëshmitarit të mbrojtur”. Është e qartë se dëshmitari Alfa nuk do ta rrezikonte jetën e tij (siç pretendonte të ketë bërë), për shkak se i vinte keq për viktimat apo për shkak se i konsideronte faktet si mizore. Në fund, kolegji vëren se deklaratat e ndryshme të dëshmitarit Alfa përkitazi me kohën kur është takuar me të akuzuarin dhe formulimi i fjalëve të përdorura për informatat (e paqarta) të grumbulluara gjatë takimeve të tilla, mënyra dhe rrethanat në të cilat i akuzuari kishte “pranuar” përfshirjen e tij, mungesa e informatave të sakta dhe precize lidhur me gjërat më themelore (p.sh. mjeti elektrik i shfrytëzuar nga i akuzuari, mënyra e transportimit të tij, mënyra e lidhjes dhe përdorimit të tij, prodhimi i tij, saktësia lidhur me sigurimin dhe vendosjen e bombës – eksplozivit dhe ekspertiza e nevojshme), si dhe hollësi të tjera jo të parëndësishme, ndryshojnë nga njëra tjetra dhe nuk përputhen në masë të duhur në mes vete (gjë e cila po ashtu është vërejtur edhe në aktgjykimin e shkallës së parë) dhe në shumë aspekte janë në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë (p.sh. aktivizimin e shpërthimit mund ta bëjë dikush që është ekspert për mjete shpërthyesë që si burim shfrytëzojnë energjinë elektrike). Përveç kësaj, përfundimisht se ndikimin e vet e ka edhe personaliteti i vetë dëshmitarit (p.sh. përfshirja e tij e mëhershme në vepra penale, tentativa e tij për arratisje dhe problemet e tjera disiplinore në burg), gjë e cila nuk e lejon Gjykatën që t’i besojë këtë dëshmitari në mungesë të ndonjë dëshmie tjetër mbështetëse.

3.4 Të gjitha këto elemente të përmendura më lart shtyjnë kolegjin që të konstatojë se dëshmitari Alfa nuk është i besueshëm dhe Gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të mbështetet në dëshmitarin Alfa, madje as ta pranojë atë si dëshmi mbështetëse dhe nuk është dashur t’i shpallë deklaratat e tij (as pjesërisht) të besueshme. Kolegji nënvizon, për ndryshim nga aktgjykimi i shkallës së parë, se deklaratat e dëshmitarit Alfa dhe personaliteti i tij duhet të trajtohen si një tërësi në kontekstin e përgjithshëm në mënyrë që të bëhet vlerësimi i besueshmërisë së tij, dhe jo të bëhet vetëm vlerësimi i pjesshëm.

#### 4. Lidhur me argumentet e tjera ligjore të ngritura në këtë ankesë

Gjatë marrjes së vendimit përkitazi me mungesën e provave të mjaftueshme mbi praninë e të akuzuarit në vendin e krimit gjatë përgatitjes apo ekzekutimit të veprës penale, Kolegji nuk u përgjigjet dokumenteve të tjera (eventuale) ligjore me të njëjtin përfundim, të ngritur nga i pandehuri. Në këtë kuptim, ankesa pranohet.

#### 5. Lidhur me vendimin e kolegjit

5.1 Kolegji, siç u përmend më sipër (pika 2), konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë ka përcaktuar mirë faktet materiale por kur bëhet fjalë për përcaktimin e gjendjes faktike *in casu*, mungesa e dëshmive bindëse përkitazi me të akuzuarin, me qëllim të zbatimit të duhur të ligjit është dashur të kalojë aktgjykimi lirues (i akuzuari të shpallet i pafajshëm). Për këtë arsye, me qëllim të zbatimit të nenit 406 (1) – 426 (1) të KPPK-së, Kolegji nuk e rikthen rastin për gjykim të sërishëm. Përveç kësaj, Kolegji është i bindur se, përkitazi me faktet penale që datojnë 9 vjet më herët, më nuk ka gjasa për mbledhjen e dëshmive të reja bindëse, prandaj për këtë qëllim kthimi i rastit në Gjykatën e shkallës së parë nuk do të kishte kurrfarë efekti të vërtetë ligjor dhe nuk do të shkonte në favor të vendosjes së drejtësisë.

5.2 Në pajtim me nenin 426 (3) të KPPK-së, kolegji ka vendosur që menjëherë ta anulojë paraburgimin ndaj të pandehurit përmes një aktvendimi të posaçëm të lëshuar më 12 mars 2009.

#### 6. Lidhur me shpenzimet për procedurat penale

Shpenzimet për procedurat penale duhet që të paguhen nga burimet buxhetore për shkak të lirimit të të pandehurit nga të gjitha akuzat, në mungesë të dëshmive kundër të akuzuarit.

Për këtë qëllim, kolegji vendos si në dispozitivin e mësipërm të vendimit.

Kryetari i trupit gjykues:

Guy Van Craen  
Gjyqtar i EULEX-it



Procesmbajtësja:

Judit Eva Tatrai  
Zyrtare ligjore e EULEX-it